



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 345/3 prot.

Tiranë më 23.2.2018

REKOMANDIM

Nr. 06, datë 23.2.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.64, datë 12.02.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Zyra Përmbartimore Vlorë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale." i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Zyra Përmbartimore Vlorë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit Nr. 64, datë 12.02.2018 të Komisionerit.

Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbartuesve gjyqësorë. Ky shërbim, ka organizim unik dhe të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kontrolluesi Zyra Përmbartimore Vlorë, në ushtrim të veprimtarisë së saj, ka kryerjen e shërbimit përmbartimor gjyqësor dhe konkretisht, ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, si marrjen e fëmijës dhe lejinin e së drejtës së vizitës të njëri prind në rastet e zgjidhjes së martesës, zbatimin e një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv me objekt të pa vlerësueshëm,

nëpërmjet të cilit debitori duhet të përmbushë një detyrim të caktuar, për vënien në posedim të sendit të luajtshëm, për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, në rastin e ekzekutimit të një vendimi për sigurimin e padisë ose me revokimin e saj, etj.

Pra, gama e të dhënave që mbledhen gjatë ushtrimit të aktivitetit përmbarimor është shumë e gjerë.

Në ligjin organik të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror, Nr.8730, datë 18.1.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", neni 26 i tij "Mbledhja dhe administrimi i të dhënave", shprehet:

"1. Përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë dhe merr masa për mbledhjen, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave që lidhen ngushtë me nevojat e ushtrimit të funksioneve e të detyrave të ngarkuara, duke respektuar garancitë kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Organet e administratës publike dhe të sistemit të drejtësisë, entet publike, si dhe personat fizikë e juridikë që kanë dokumente dhe të dhëna që lidhen me ekzekutimin, janë të detyruar t'i paraqesin kur u kërkohen nga përmbaruesit gjyqësorë.

3. Të dhënat e marra në përputhje me këtë nen grumbullohen, administrohen, ruhen dhe/ose asgjësohen, në përputhje me dispozitat përkatëse në fuqi".

Ky nen i jep përmbaruesit gjyqësor të drejtën e mbledhjes dhe administrimit të të dhënave për nevojat e ushtrimit të funksioneve e të detyrave të ngarkuara, duke patur parasysh respektimin dhe garancitë kushtetuese dhe ligjore për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Zyra Përmbarimore Vlorë, është kontrollues i cili mbledh dhe grumbullon të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe përmbarues gjyqësor" dhe "subjekte që marrin pjesë në ekzekutim".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, në datë 20.02.2018 u konstatua:

1. Kontrolluesi Zyra Përmbarimore Vlorë, nuk disponon rregullore për mbledhjen përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi Zyra Përmbarimore Vlorë, nuk ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.

Përfaqësuesi i kontrolluesit, Zyra Përmbarimore Vlorë, nuk paraqiti pretendime në lidhje me konstatimet.

Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi Zyra Përmbaremore Vlorë, të hartojë Rregulloren për "Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale".
2. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi Zyra Përmbaremore Vlorë, të nënshkruajë "Deklaratat e Konfidencialitetit" me punonjësit dhe përmbareuesit gjyqësor, sipas standardit të përcaktuar në Vendimin Nr.6, datë 05.08.2013 të Komisionerit, për "Përcaktimin e rregullave të Hollësishme për Sigurimin e të Dhënave Personale".
3. Kontrolluesi Zyra Përmbaremore Vlorë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 23/2 /2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

